

PANAJOT ZOTO

**TË FORTËT**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA



PANAJOT ZOTO

# TË FORTËT

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-376-36-7

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

## Parathënie

Pas shpalljes së Pavarësisë, në historinë mbi njëshekullore të shtetit shqiptar, ajo që shënon kthesën e madhe, si një ndryshim epokal në marrëdhëniet shoqërore dhe zhvillimet politike në vend, është dhe mbetet përmbysja e sistemit totalitar dhe zëvendësimi i tij me pluralizmin politik dhe demokracinë, produkt i revolucionit antikomunist i protestave studentore...

Të gjithë ata që i kanë jetuar ditët, muajt dhe vitet e para pas marsit të vitit 1992, i kanë të freskëta edhe sot euforinë dhe sigurinë, me të cilat përcilleshin premtimet për demokracinë dhe Europën nga ata që u vunë në krye të drejtimit të vendit dhe morën përsipër barrën e rëndë të ndryshimeve. Për shumë vëzhgues të huaj, Shqipëria e atyre viteve po përballej me një transformim të vrullshëm dhe njerëzit po përthitheshin nga trazirat politike, edhe pse pa ditur se ku do t'i çonte ky rrugëtim. Për shumë të tjerë, madje për shumicën e shqiptarëve, gjithçka ishte një luftë për mbijetesë, për të mbuluar nevojat më bazike, por, gjithsesi, ekzistonte një shtysë dhe dëshirë e jashtëzakonshme për të prekur dhe jetuar lirinë e mohuar dhe të refuzuar kaq gjatë.

Në fakt, sa për mungesë përvoje, por më shumë qëndrimi e orientimi politik, nga njëra anë, dhe tejkalimit të së drejtës së lirisë apo abuzimi me të, nga ana tjetër, Shqipëria u përfshi nga e ashtuquajtura “zallamahi demokratike”, me grabitje, rrënim e shkatërrim të gjithçkaje, që ishte ndërtuar me punën e djersën e popullit. Dhe kjo në emër të antikomunizmit.

Me termin “demokraci” u bë shumë demagogji, dhe politika e veshur me këtë rrobë kamuflazhi degjeneroi në një politikë që prodhoi krim, korrupsion, hajdutëri, grabitje, zaptim tokash, paligjshmëri në ndërtim dhe pafuqi të institucioneve shtetërore.

Kjo plagë në trupin e foshnjës së sapolindur u mahis nga pamundësia e politikës dhe politikat joadekuate të qeverisjeve në vitet e mëpasme (ndoshta edhe deri sot) për të luftuar të këqijat. Madje, mund të thuhet se politika e pasviteve '90, krahas krimit e hajdutërisë, inkurajoi kultivimin dhe trafikimin e drogave dhe të qenieve njerëzore, si të këqijat më të mëdha, që bashkëshoqëruan të gjitha përpjekjet për zhvillim dhe, në mënyrë indirekte, frenuan reformat dhe përparimin e vendit në rrugëtimin drejt familjes europiane.

Lidhja e politikës me krimin ishte dhe mbetet ende shtrati i bashkëjetesës së të mirës me të keqen, i dëshirës, por dhe i pamundësisë për të larguar retë e zeza nga qielli i pastër i këtij vendi, që mban edhe sot në kurriz individë e grupe të fortësh, që bëjnë shpesh ligjin, madje i duhen dhe i përthith politika për interesa pushteti, fitimi e pasurimi.

Ky libër nuk është thjesht pasqyrim i këtyre realiteteve, por dhe një aktakuzë për klasën politike të këtij

tranzicioni të gjatë, mbi të cilën bie e gjithë përgjegjësia për mospërparimin e kërkuar të vendit dhe, ç'është më kryesorja, mbajtja e një standardi të ulët të nivelit intelektual të të zgjedhurve, çka ka prodhuar një klimë konflikti, që shpesh ka inkurajuar dhe lënë dritare të hapura, që “të fortët” e këtij vendi të mos ia kenë frikën shtetit dhe ligjit.





**Rrugët e Shqipërisë** ishin po ato, të trashëguara nga regjimi i kaluar. Ajo që kishte ndryshuar, krejt si papritur, ishte shtimi i mjeteve që lëviznin në to. Edhe pse nuk ishte mbyllur i pari pesëvjeçar prej ditës kur u shpall pluralizmi, me përmbysjen e sistemit monist, bumi i autoveturave ishte sinjali i ndarjes me të kaluarën komuniste. Tani, nëpër rrugët e ngushta e pa standarde, autoveturat e blera në Perëndim dukeshin si dallëndyshet e para të kapitalizmit shqiptar... Kjo e bënte Endri Pilon edhe më të vendosur për t'iu ngjitur me kurajë të përpjetës ku, sipas tij, “dëshira dhe forca sjellin suksesin”. I dha gaz autoveturës sapo kaloi urën e Orikumit, pastaj përshkoi kthesat e para të rrugës që kalon nëpër Fushë-Dukat dhe iu drejtua malores drejt Qafës së Llogorasë. Ishte nisur për në Jug, në qytetin ku, si thoshte, të parët e tij ishin pronarë të dhjetëra hektarëve tokë. “Do të bëhesh pronar e biznesmen, o qerrata”, i thoshte vetes duke parë fytyrën e tij të qeshur në pasqyrën e autoveturës dhe, si të ndodhte kjo mrekulli sa hap e mbyll sytë, nxirrte nga brenda vetes luzmën e kënaqësisë. Shtriqej në sedilje dhe

trokiste me gishta mbi timon sipas ritmit të këngës “Dhuratë për ditëlindjen”, që e këndonin shpesh në vitet e gjimnazit. Kur nisi lëvizja studentore dhe filluan protestat kundër komunistëve në pushtet, Endri Pilo, “sportisti”, siç i flisnin shokët, ngaqë bënte pjesë në ekipin e volejbollistëve të qytetit, shkonte gati çdo ditë nga Durrësi për t’iu bashkuar studentëve në protestat e tyre në Tiranë. U bë i njohur jo vetëm në rrethet studentore, por edhe nga elita antikomuniste e kohës, dhe ishte një nga anëtarët e grupit të ngarkuar për ngritjen në qytetin e Durrësit të seksioneve të para të forcës më të re politike të themeluar atëkohë: Partia Demokratike e Shqipërisë.

Nuk e ndante asgjë me regjimin e kaluar, përkundrazi. Familja e tij ishte përfituese nga të mirat që kishin komunistët dhe individët me detyra në administratë. Babai i tij, Sokrati, brigadier në Parkun e Mallrave, edhe pse i kapur disa herë në allishverishe duke përdorur makinat e ndërmarrjes për ndërtimin e një banese private në *Lagjen 14* të qytetit, ia hidhte, për shkak se me këto mjete, që punonin për ndërtimin e pallateve me kontribut vullnetar për strehimin e punonjësve, kishte ndihmuar edhe drejtorin e ndërmarrjes për ca punime në shtëpinë e tij. Endri ishte në vitin e tretë të shkollës së mesme dhe e mbante mend mirë ditën kur babai i tij u bë objekt debati në organizatën e frontit të lagjes. Një nga banorët kishte ngritur problemin e vjedhjeve dhe përdorimin e materialeve të ndërmarrjes për punë personale, dhe kishte përmendur me emër Sokratin, që “në kundërshtim me moralin socialist, po dëmtonte, për interesa personale, pronën e përbashkët”. I kishte

mbetur në kujtesë si diçka e veçantë ajo ditë Endri Pilos, sepse ishte dita që kishte shënuar krisjen e lidhjeve të tij me sistemin. Ishin vitet kur qeveria komuniste mundohej me “sakrifica” të mbante në këmbë shtetin, i cili i ngjante një të sëmuri në reanimacion dhe priste vdekjen e sigurt. Sokrati, si shumica e shqiptarëve, e ndiente këtë, por ndryshe nga të privilegjuarit e sistemit, ai iu bashkua korit të të pakënaqurve.

Këto sillte ndër mend Endri, teksa *Benz*-i gulçonte në të përpjetën e Dukatit në ngjitje drejt Qafës së Llogorasë. Ishte i bindur se për këtë shkak nuk shkoi në universitet pas mbarimit të gjimnazit. Por kjo nuk e kishte ligështuar. “Ja ku jam, dhe të ardhmen do ta kem të lumtur”, i thoshte vetes.

E ndali *Benz*-in në pikën më të lartë, ku pas gjelbërimit të pishave në ngjitje, para tij u shfaqën të madhërishme visaret malore me Kreshtat e Vetëtimës dhe poshtë deti me një kaltërsi magjepsëse, i shtrirë si një qilim i kaltër përgjatë gjithë Bregut, ku zë fill dhe historia e të parëve të tij. Edhe pse Sokrati kishte lindur në qytetin-port të Adriatikut, lidhjet me vendlindjen e të parëve nuk i kishte prerë, të paktën shpirtërisht. Ai nuk e mohonte që ishte djalë nga Bregu dhe në biseda me shokët krenohej për stërgjyshërit e tij me emër në gjithë krahinën e Himarës, si detarë të zotë dhe luftëtarë në betejat për mbrojtjen e qytetit. Endri e kishte studiuar në detaje pemën gjenealogjike të familjes dhe kishte gjetur jo pak të dhëna e fakte për trevën e vendlindjes së të parëve, edhe për katragjyshin e tij, Forjanin, që ishte në krye të një flote tregtare me bazë në ishullin Hydra në fillimet e shekullit XVIII.

Ai, edhe pse në moshë të thyer, kishte marrë pjesë, vite më vonë, në një betejë për mbrojtjen e ishullit, si komandat i një anijeje luftarake me kreshtë lundrimi, e pajisur me hedhës guri.

Kur *Benz*-i me gulçima kaloi qafën e “Vumloit”, në dalje nga Himara, Endri vuri këmbën në frena dhe ndali autoveturën. “Të ftohet pak motori”, mendoi dhe zbriti. Ngriti pastaj kofanon dhe pa të ngriheshin lart avuj të nxehtë. Instinktivisht ktheu kokën dhe vështrimin e rrëshqiti gradualisht nga lart (ku dalloheshin majat e thepisura), në zbritje të shpatit, ku ngrihej mbi një kodër fshati i të parëve të tij.

- Eh...! - psherëtiu dhe hapi derën e makinës, u ul në sedilje dhe u largua nga ajo pamje, që edhe pse fizikisht nuk kishte lidhje, zemra ndiente diçka për të. Atje lart (babai i kishte folur shumë për fshatin e të parëve) e dinte se të mbeturit ishin të pakët. Në shekuj, dekada e vite largimet e gjymtuan fshatin, dhe jo vetëm atë, por gjithë Bregun. Familje të shumta kapërcyen Otranton pas pushtimit osman. Të tjera mbetën në Kerkyra, jo pak u vendosën në Vlorë e qytete të tjera të vendit. Në qytetin jonian nuk ishte i panjohur dhe as njeri pa njeri. Kushërinj të largët e kishin afruar dhe me ta kishte nisur “betejën” për gjetjen dhe marrjen e pronave të trashëguara, si thoshte.

\*\*\*

Njerëzit e tij në qytet e kishin përgatitur takimin. Qëllimi ishte që dosja të plotësohej me dokumentacionin

përkatës dhe mospërputhjet të ndreqeshin. Këtë do të kërkonte Endri nga drejtori i urbanistikës së rrethit. Hartimin e një “Gen-plani” për gjithë sipërfaqen që pretendonte pronësinë, në disa mijëra metra katrorë, në atë lagje ku përfshiheshin edhe objekte shtetërore. Miku i tij në Vlorë, Admiri, i njohur si Mir Qorri, që kishte privatizuar në atë kohë disa dhjetëra hektarë tokë bujqësore dhe troje, e kishte udhëzuar për mënyrën se si do të mundte që t’i shtinte në dorë këto prona. Ryshfeti dhe kërcënimet, pse jo edhe ndërhyrjet e “të mëdhenjve” me të cilët ai ishte lidhur, i kishte thënë.

Fillimisht ata folën për gjëra pa rëndësi, si bëhet zakonisht në takime ku palët nuk ulen si miq, por si palë interesi. Endri e pyeti për shëndetin, për fëmijët dhe prindërit, që drejtori kishte në fshat. Nëse shkonte për t’i parë... Të njëjtën gjë bëri edhe drejtori i urbanistikës. Pastaj folën për qytetin, për detin... dhe në një moment Endri, si rastësisht, e pyeti për lidhjet e tij me partinë...

- Je anëtar, apo jo?

- S’ka rëndësi, - ishte përgjigjur drejtori i urbanistikës me një zë flegmatik, duke iu shmangur interesimit të bashkëbiseduesit.

- Ç’është keqe ka? Unë jam demokrat dhe e them hapur. Po fjalën e kisha në kuptimin e marrëdhënieve me titullarin me të cilin, kuptohet, duhet të kesh marrëdhënie të mira e të jesh i besueshëm për të, sepse kështu do të mundesh të bësh jo vetëm karrierë, por edhe të fitosh duke ndihmuar edhe të tjerët.

Drejtori i urbanistikës vuri buzën në gaz duke e zhbhiruar me një vështrim të vagëllimtë bashkë-

biseduesin. “E ka me qitje të largët”, tha me vete, dhe iu drejtua atij me një ton pyetës, se nuk besonte ta kishte kërkuar takimin për të folur për punë partish.

- Kur isha i vogël, - vijoi Endri, - babai më fliste për qytetin, për njerëzit e tij që banonin këtu. Më ishte fiksuar dhe e ëndërroja këtë ditë ku e kaluara mbetet si njollë e keqe në kujtimet tona, ndërsa e sotmja na buzëqesh dhe e ardhmja është gati për t’u shkruar.

- Nuk do të flasim për ëndrra, apo jo? - belbëzoi me ironi drejtori dhe një buzëqeshje rrëshqiti mbi buzët e tij mavi.

- Natyrisht, jo. Por është e vërtetë kjo që them. Qysh i vogël më pëlqente të hidhja vështrimin larg dhe të ëndërroja.

Drejtori i urbanistikës kishte një natyrë flegmatike. Fliste pak, por brenda asaj hapësire të vogël komunikimi bashkëbiseduesi arrinte të kuptonte se ç’fshihej brenda nëndërgjegjes së tij. Ishte, si thoshin për të, një skuth, që gjithnjë i fshihte veprimet dhe qëllimet.

- Të flasim për sot. Nuk besoj se më ftove thjesht për një kafe, - këmbënguli drejtori, ndonëse e kishte tashmë përvojën se “të fortët”, si bashkëbiseduesi në këtë rast, e shtronin udhën gjer te kërkesa që kishin, fillimisht, me fjalë e fraza si këto pa interes, thjesht sa për hyrje në temë.

- Më duhet një planimetri e territorit tek ish-repartit, që përfshin pjesën e lagjes dhe ish-ndërmarrjet shtetërore, - i tha Endri.

- Arsyeja? - pyeti shkurt drejtori i urbanistikës.

- Jam duke plotësuar dosjen për Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

- Me ç'dokument vërteton pronësinë mbi atë territor? - e pyeti përsëri drejtori.

- Kjo nuk besoj se të intereson, apo jo?

- Natyrisht që po, sepse mbaj përgjegjësi ligjore nëse do të nënshkruaj mbi dokumentin që më kërkon.

Endri nuk foli, por bëri një lëvizje sanguinëshe mbi ndenjësen e rehatshme. E treti pastaj vështrimin tejdetit, ku retë ishin grumbulluar në majën më të lartë të ishullit, dhe tha se po vinte shiu. Drejtori i urbanistikës rrekej me vete të kuptonte se ku donte të dilte bashkëbiseduesi me paralajmërimin për shi, ndërsa ajo që kërkonte ishte më shumë se një tërmet. Mbeti i heshtur duke menduar me kokën mbështetur në pëllëmbën e dorës së djathtë, ndërsa me dorën e majtë sillte vërdallë, kot së koti, lugën e kafes, që e kishin mbaruar së piri prej kohësh.

- Le të bëjmë një marrëveshje, - tha Endri, duke e thyer heshtjen.

- Marrëveshje? Përse?

- Sot çdo gjë paguhet. Fol sa kërkon. Ti do të bësh punën, do të marrësh paratë, dhe...

- Pastaj të hesht. Kjo është marrëveshja, apo jo?

- Në këtë çështje nuk jam i interesuar vetëm unë. Ka të tjerë më lart që interesohen... Jemi në një betejë të re dhe jeta është betejë, herë humbet dhe herë fiton. Unë dua ta fitoj këtë betejë. Pranon?

- Jo, jo! Nuk mund të pleksem...

- Pse jo? Ti ke kohë që je pleksur...

- Ç'do të thuash? Ç'di ti për mua? - pyeti drejtori si i kapur në faj. Para syve iu shfaq ruleta ruse, ku shikonte

se në çdo pikë ndalese pas një rrotullimi, t'i dilnin me radhë favoret, lejet e ndërtimit që kishite dhënë, shpesh në shkëlqe të ligjit. Pastaj iu drejtua bashkëbiseduesit: - Ta marr për shantazh këtë?

- Aspak, të kujtoj vetëm “vendimet e vulosura”, që i mban gjithnjë me vete, - i tha Endri me një ton të paqtë.

Njerëzit e tij kishin hetuar në veprimtarinë e drejtorit të urbanistikës dhe kishin zbuluar të ashtuquajturën “listë”. Bëhej fjalë për një vendim këshilli për dhënie trojesh ndërtimi. Drejtori i urbanistikës, duke shfrytëzuar një vendim të këshillit bashkiak, i kishte marrë tinëzisht firmën kryetarit për një numër të konsiderueshëm vendimesh pa emër përfituesi, dhe i plotësonte ato me emra (duke i shtuar në listën e miratuar në këshill) në këmbim të parave. U kërbunj mbi karrige si të ishte një plak, dhe ndjeu mbi vete peshën e një goditjeje si ato që bëhen nën brez. “Qeni kafshon vetëm të varfrit”, nëpërdhëmbi heshtur, dhe ndjeu që brenda qenies së tij të ishin dy persona të ndryshëm nga karakteri. Kush ishte ai në të vërtet? Mbylli sytë dhe pa në të kaluarën. Nuk shikonte njolla përgjatë rrugëtimit të tij, ndërgjegjen e kishte të pastër. Dikur ishte i qetë, por... ndryshimi i sistemit ndryshoi edhe lojën dhe kjo bënte që shpesh ai të pështjellohej dhe shpërqendrohej në vendimet që merrte. Sot ishte tjetër njeri, i dukej vetja si një “vrasës”, që mbante maskën e moralistit. Dhe nuk ndiente fajësi, as brerje të ndërgjegjes...

Endri priste i qetë reagimin e drejtorit pas goditjes që i dha. E kuptonte se atë, më shumë sesa ndjenja e



fajit, e torturonte makthi, por s'kishte nga të lëvizte. Ishte zënë si në çark. Kjo ishte e vërteta që shikonte dhe përsëriti me vete thënien e dëgjuar disa herë për raste të ngjashme: “E vërteta është që gjërat thjesht ndodhin”.

- Nuk është e vërtetë që i ke ato vendime? - e pyeti pastaj në mënyrë provokuese. Drejtori i urbanistikës nuk iu përgjigj, por me heshtjen ai fliste, dhe Endri e kuptonte, ndaj ia përsëriti pyetjen. Drejtori i urbanistikës, si të ndiente barrën e botës mbi shpatulla dhe pafuqinë përballë faktit, u dorëzua.

- Besoj se gjithçka e thënë këtu do të mbetet mes nesh. Në të kundërt jemi të dy të humbur, - tha dhe ndjeu t'i regëtinte zemra nga sikleti.

- E ke dëgjuar thënien: “Zogjtë e të njëjtit lloj fluturojnë bashkë”? E pra, jemi të njëjtë në nisje të rrugës drejt suksesit dhe bashkëpërfitues. Nuk ke pse dyshon, - e siguroi Endri dhe u ngrit. I dhanë dorën njëri-tjetrit dhe lanë një takim tjetër për të diskutuar detajet.

Ndenji gjithë atë javë në qytetin jonian. Nga dhoma e hotelit ku qëndronte sodiste gjithë bregun dhe me sytë e mendjes përfytyronte resortin turistik që kishte në plan të ndërtonte, që sipas tij nuk do të ishte vetëm një burim fantastik të ardhurash, por edhe një vend takimi me ata që ai i quante pjesëtarë të së njëjtës familje: politikanë, prokurorë e gjyqtarë, të cilëve do t'u ofronte mjedise pushimi dhe do t'u kërkonte, në

këmbim, favore. E ëndërronte këtë ditë dhe kishte vënë një bast me veten.

Ishte takuar me kryetarin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me të cilin ranë dakord edhe me një shumë modeste parash. “Për mua, i kishte thënë ai, rëndësi ka që të kemi dokumentet e nevojshme. Komisioni nuk mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Është prokuroria dhe gjykata që mund të hetojnë, nëse do të ketë kundërshti nga palë të treta.” Këtë e dinte mirë Endri, prandaj e priste me një dozë paragjykimi takimin me Pedrin, gjyqtarin, që ia kishte rekomanduar miku i tij gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Tiranë, Hysen Mborja. “Është nga tanët. Mjafton t’ia ngrohësh xhepin dhe... dorëzohet”, i kishte thënë. Me të u takua në një nga sallat e hotel “Turizmit”, atje ku gjyqtarët pinin kafën e përditshme.

Pasi dëgjoi parashtrimin e Endrit dhe kërkesën për ta marrë ai në shqyrtim padinë civile për njohjen e pronës, sipas vendimit të KKKP-së së Bashkisë, Pedri përmbysi filxhanin e kafesë, vuri mbi të pëllëmbët e duarve dhe ndenji për një kohë i heshtur, si për t’i dhënë rëndësi vetes.

- Të dërgon të fala zoti Mborja, besoj e njihni, - i tha Endri, duke e ditur lidhjen mes tyre.

Pedri u çel në fytyrë i ngriti duart nga tavolina dhe me pëllëmbët që kishte mbuluar filxhanin e përmbysur, mbuloi fytyrën, pastaj fërkoj sytë që i shkëlqenin.

- E njihni? - pyeti shkurt, duke mos e fshehur habinë, pse jo dhe një lloj mburrjeje që ishte i njohur në rrethet e larta të gjyqësorit.

- Më ka rekomanduar te ju. Më tha se jeni pjesë e familjes politike dhe unë i mbahem parimit se “rrobat e palara gjithmonë lahen në familje”, - tha Endri.

Pedri vuri buzën në gaz, pastaj qeshi me të madhe. E kishte dëgjuar këtë thënie nga goja e personit që i shërbente, sa herë ai i kërkonte për të marrë një vendim në favor e në mbrojtje të individëve që paguanin. E kuptonte se vetëm duke u shërbyer atyre lart, mund të mbetej i fortë dhe të bënte, si thoshin për të, ligjin në gjykatën e rrethit. Ai e kishte një synim. Donte të ngrihej lart, për të mos u përdorur gjithnjë si një gomë rezervë prej tyre. I tha se nuk duhej të shqetësohej. Madje e bëri fakt të kryer një vendimmarrje në favor të tij.

- U tha, u bë, - përmendi një shprehje që përdoret rëndomë në këto anë. Për të nuk ishte ndonjë gjë e re në marrëdhëniet e tij me enturazhin.

U ndanë, pasi saktësuan përfitimet e palëve në këtë transaksion juridiko-pronësor.

Vjeshta e vitit 1994 nuk ishte thjesht një stinë me ngjyrën simbol të së verdhës së gjetheve, por dhe një stinë me ditë e muaj, ku bluja e partisë në pushtet mori rrugët për të trokitur derë më derë, t’u kërkonte shqiptarëve besën. Endri, bashkë me “shtabin”, ngritur nga dega e partisë në qytetin-port, ndiqnin përditë zhvillimet politike dhe prisnin përfundimin e punimeve të kuvendit, i cili do të miratonte ligjin për referendumet. Në forumet qendrore dhe vendore të

partisë po bëheshin përgatitjet. Ishin dhënë udhëzimet dhe pritej fillimi nga puna me njerëzit. “Debati në parlament është thjesht një formalitet, sepse zëri i opozitës është i mekët ngaqë nuk i kanë numrat për t’u imponuar”, u thoshin anëtarësisë në bazën e partisë deputetët e shumicës parlamentare. Edhe shtypi, ndonëse konsiderohej i lirë dhe i pavarur, nuk guxonte të thoshte të vërtetën dhe fliste me gjysmë zëri se “referendumi”, që kërkohet nga shumica në parlament, është një lojë, pasi presidenti mendon se e ka më të lehtë t’i marrë me shumicë votat në popull. Në fakt, shtypi i referohej diskutimit të Dritëro Agollit, deputetit ikonë të opozitës, që me sarkazëm therëse thoshte që komisioni për hartimin e kushtetutës, i ngritur nga kuvendi, është marrë peng nga presidenti, që me sa duket, e quan të sëmurë dhe të pafuqishëm, prandaj kërkon t’ia rrëmbejë atë për t’ia dhënë dikujt tjetër. Nga foltorja e parlamentit, ai denonconte presidentin, duke thënë se një herë, ai kishte menduar që t’ia jepte këtë komision bashkë me kushtetutën një asambleje kushtetuese, të formuar me dekret dhe tani po ia jep të ashtuquajturit “referendum”, duke vrapuar hajdutçe të lajmërojë popullin: “Hej... unë ia mora kushtetutën kuvendit, se është i sëmurë, dhe po ta jap ty, o popull!”.

Kujtonte këto episode Endri, teksa “ecte” me hap të shpejtuar mbi pistën vrapuese në atë palestër force, që e frekuentonte thuajse në mënyrë të përditshme. Ishte dita kur mbushej një vit i plotë nga dështimi i projektkushtetutës, përgatitur jashtë parlamentit dhe dërguar në referendumin popullor nga Presidenti i Republikës. Endri kujtonte ato ditë plot entuziazëm të

fushatës kur presidenti e kishte pushtuar me hapin e tij të gjatë gjithë territorin e vendit, nga Kukësi në veri gjer në Konispol në jug. E megjithatë rezultoi humbës, paçka se nuk e konsideroi humbjen si humbje, duke ia faturuar atë jo vetes, por kundërshtarëve politikë. “Referendumi e rrëzoi projektkushtetutën, por unë përfitova”, nëpërdhëmbte Endri, teksa priste mbarimin e seancës për të shkuar në selinë e partisë, ku ishte njoftuar mbledhja e radhës. Ai ishte shpërblyer për punën e bërë me elektoratin në Lagjen 14, ku shumica e votave shkoi për “Po”-në. Posti i nëndrejtorit ekonomik të spitalit, ishte një vlerësim që partia i bëri punës së tij dhe kjo e bënte të shikonte larg, ta kërkonte suksesin dhe famën, që mendonte se të bën njeri të rëndësishëm. Kishte lexuar diku për këtë dhe shpesh përsëriste thënien: “Fama është armë e rëndësishme, nëse përdoret me inteligjencë”.

Pasditja e asaj të mërkure (në 1-vjetorin e humbjes së referendumit) ishte e ngjeshur me punë e takime. Fillimisht mbledhja në seli, pastaj në spital, ku, mbase edhe rastësia e solli, u takua me personin për të cilin i kishte folur Besoja, njeriun që menaxhonte prodhimin dhe tregun e kanabisit, Lencin nga fshati Rrëzmal. Me Beso Canin, ish-policin, kishte folur kur ishin takuar në Butrint një vit më parë. Ia vlerësonte aftësitë dhe ishte i bindur që bashkë do të bënin shumë punë. Besoja me fisin e tij në fshat ishin ndikues dhe bënin ligjin jo vetëm në rrethinat e qytetit, por thuajse në gjithë rrethin. Ishin pjesë e grupit të “të fortëve”, që partia i mbronte dhe i stimulonte për të mos humbur

zonat e influencës. Ishin njohur në Korçë, ushtarë në një regjiment artilerie dhe të dy pak problematikë për repartin, pasi kishin qasje liberale ndaj rregullores dhe nuk u bindeshin lehtë urdhrave. “Lenci është personi që do të sigurojë ‘mallin’ dhe e do një garanci për transportin drejt bregdetit”, i kishte thënë Beso Cani në takimin e tyre në Butrint, ku i kishte kërkuar të shfrytëzonte njohjet e tij edhe për trafikimin drejt brigjeve përtej detit.

Ishin ulur te “La bella”, një lokal në bulevardin kryesor, pranë kinoteatrit, dhe po gjerbnin kafënë që kishin porositur. Përballë njëri-tjetrit ata debatuan për minuta të tëra për ofertën dhe gjetën gjuhën e mirëkuptimit, që, natyrisht, përmbante përfitimet. Pastaj folën mbi mënyrën e transportit, të rrugëkalimeve, pikave të sigurta të grumbullimit të dërgesave, personat e kontaktit aty ku prisnin gomonet dhe realizimin, rast pas rasti, të transportit matanë detit etj.

- Është një zinxhir i tërë pune dhe një duzinë të punësuarish për realizimin e dërgesave nga Rrëzmali në destinacionet përtej detit, - i thoshte Lenci, ndërkaq Endri i kërkonte fshehtësi. I thoshte se në asnjë moment dhe në asnjë vend nuk duhej përmendur ai me emër, duke i dhënë, nga ana tjetër, garanci se gjithçka e biseduar ishte një sekret mes tyre, dhe angazhim i tij për të realizuar transportin e mallit.

- Kemi njerëz të besuar në polici, këtu dhe në gjithë bregdetin deri në Sarandë, - kishte thënë gati me

mburrje. Pastaj e kishte pyetur Lencin për garancitë që kishin kultivuesit dhe prodhuesit e mallit. - Ata nga lart na tolerojnë sot, por nesër nuk i dihet. Duhet të përgatitemi të përballojmë atë që mund të vijë më pas. - Lenci buzëqeshte me qesëndi, duke e parë drejt e në sy Endrin, sikur t'i thoshte “mos na e ki merakun”.

I ishte kujtuar biseda që kishte bërë me një politikan dhe porosia e tij për të besuar në atë që bën dhe frytet që vinë më pas. “Mbase do të duhet të bësh një hap mbrapa, por do të ecësh më fort pastaj”, i kishte thënë ai. “Gjithçka e kemi nën kontroll”, kishte shtuar më pas. I ofroi një cigare Endrit, por ai refuzoi. Mospirjen e duhanit e konsideronte si një përparësi për shëndetin. Ndërkaq Lenci i tregoi një cigare të përgatitur me gjethet e “mallit”, si për t'i thënë Endrit se jeta dhe shpirti i duan të gjitha...

Këtu ishte mbyllur takimi. Ishin ndarë miqësisht dhe, ndërsa autovetura mori kthesën në rrugicën përballë lokalit, duke lënë pas tymin mbytyës, Endri e përcolli me një vështrim të turbullt, gati nënvlerësues, i bindur se Lenci nuk do të mund të bëhej dot një shemër për të. Ishte ambicioz dhe synonte gjithnjë ngjitjen, jo zvarritjen brenda tarikatit...

Kishte rënë muzgu dhe rrugët po boshatiseshin nga kalimtarët. Ai ecte me hap të ngadaltë dhe ndiente kënaqësinë e një puhize ere që vinte nga deti. Iu afrua bregut dhe me vështrimin tretur tutje në tisin e errët shtrirë mbi det, ku disa anije shpërndanin ndriçimin mbi ujë, meditonte duke nxjerrë nga brenda vetes gjithë “ahet” e jetës, pse jo dhe brengën më të madhe,

dashurinë e parë të humbur. Ishte bërë baba dy vite më parë, por Zana, nëna e djalit 2-vjeçar, nuk e kishte sharmin, hijeshinë, shikimin hipnotizues, shkëlqimin dhe dëlirësinë e vajzës që donte, Vjollcës, shoqes së gjimnazit. Ajo kishte ikur shpejt nga kjo botë dhe Endri i ishte nënshtruar fatit. E kishte dëgjuar nga gjyshja e vet thënien se me fatin nuk bëhet pazar, ndaj ishte detyruar të ndanin së bashku me Zanën përditshmërinë, duke e mbajtur brenda vetes dhimbjen dhe trishtimin. Shpesh makthi e linte pa gjumë dhe ai përsëriste premtimin e dashurisë që, sa herë takoheshin me Vjollcën, ia thoshte: “Të dua të të kem me vete, të të buzëqesh çdo mëngjes pas gjumit dhe të të përqafoj kur të jesh e trishtuar”.

Kishte ndenjur për një kohë i ulur në stolin e betontë, pa e kuptuar egërsinë e papritur të detit me shkulmin e bardhë që përplaste në breg. E kaluara shkërmoqej para syve të tij dhe kërkonte të shihte e të jetonte të sotmen, realitetin e ri, pa iu nënshtruar rastësisë, por t’i sundonte dhe menaxhonte pasionet dhe të ardhmen që shihte me sytë e mendjes. Ai dinte të përballej me vetveten dhe t’i shmangej turthit për arritjen e synimeve. Kishte ëndrra. Dhe për t’i bërë ato realitet, nuk pendohej për rrugën e zgjedhur.

Endri e kishte kërkuar gati me urgjencë Hysenin, gjyqtarin e Apelit të Tiranës, pas marrjes së njoftimit se Shërbimi i Kontrollit të Shtetit kishte kërkuar nga pushteti vendor dhe prokuroria e rrethit pezullimin



e punimeve në resortin e tij në Bregdet. Ankesat e atyre që pretendonin për grabitje të pronës përmes dokumenteve të falsifikuara e kishin bërë efektin. Në dokumentin e nënshkruar nga kryetari i institucionit më të lartë shtetëror të kontrollit i kërkohesh pushtetit vendor që të merrte masën e pezullimit të punimeve dhe prokurorisë për të rishikuar ligjshmërinë dhe mënyrën e privatizimit të truallit. Ata ishin takuar në Vlorë, ku i pritën në një lokal modest në Kuzbaba, Mir Qorri. Edhe ai kishte probleme me disa prona. Ishte në procese gjyqësore dhe kërkonte të rrimonte në biografinë e karrierës së gjyqtarës Enkeleda Mandia, për ta shantazhuar, që ajo të mos bënte shaka me vendimet që do të merrte.

- Rëndësi ka të mbështesim njëri-tjetrin dhe të ruajmë qetësinë. Nuk ka pse të krijohet një konflikt për të zgjidhur një konflikt që ekziston tashmë mes jush dhe personave që kanë ngritur akuza dhe pretendime, - tha Hyseni, pasi dy miqtë e tij i folën për problemet me pronat dhe një rast konflikti me policinë në Vlorë.

- Nuk më rruhet nga ajo anë mua, - tha Miri. - Këtu në Vlorë s'ka Zot që...

- Dakord, dakord, - e ndërpreu gjykatësi, - por shpesh njeriu humbet nga besimi i tepruar në veten e tij dhe...

Miri nuk e la të mbaronte dhe të shprehte mendimin miku i tij, duke ndërhyrë me logjikën e të fortit, që sipas tij nuk ka tërheqje, sepse në lojë janë interesat, për të cilat duhet qëndruar fort.

- Të qëndrosh fort në interesin tënd do të thotë të mos pushtohesh nga ndjenjat e këqija. Duhet bërë

kujdes, - tha me nxitim gjykatësi, dhe shtoi: - E kam nga përvoja ime këtë që them.

Biseduan gjatë duke i marrë me radhë çështjet, për të cilat kërkonin mbështetjen e gjyqtarit nga Tirana. Për shkresën e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, fillimisht Hyseni mori përsipër të bisedonte me prokurorin e rrethit dhe t'i kërkonte ta fuste atë në sirtar e të mos vepronte.

- Kjo, - kishte thënë, - është një çështje procedure. Është thjesht një kërkesë pa fuqi ligjore. Është e drejta e organit të akuzës nëse e ndjek apo jo, vepron apo nuk vepron... Ndërkaq pushteti vendor është kryetari dhe me kryetarin e di ti vetë ç'duhet bërë, apo jo? - tha dhe qeshi.

Problem ishte Enkeleda, gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila nuk kishte pranuar ndërhyrje, madje as të bisedonte me personat që kishin kërkuar ta kontaktonin në emër të Mirit. I kishin ofruar edhe para, të cilat i kishin të bollshme. Ata ditën të përfitonin dhe të rritnin fitimet çmendurisht, ngaqë ishin pjesë e mekanizmit të funksionimit të firmave piramidale dhe me fitimet e nxjerra, jo vetëm shtuan pasuritë, por krijuan, përmes korrupsionit, “familjen e madhe të miqve” nga politika, drejtësia, policia, të mbështetur nga njerëz të botës së nëndheshme, që ishte bërë realitet dhe po merrte udhën në ngjitje, në ato vite. Hysen Mborja thoshte shpesh se familja e vërtetë nuk është ajo që kemi brenda banesës ku jetojmë.

- Familja e vërtetë, - thoshte ai, - janë njerëzit që ke rrotull. Në një familje të madhe si e jona problemet përballohen bashkë.

- E kemi një zgjidhje edhe për këtë, - tha gjykatësi pastaj dhe, si njeri pa skrupuj që ishte, nxori anën e keqe të shpirtit të tij, si ata që kur duan të arrijnë diçka asgjë s’i ndal. - Enkeleda e ka lyer gishtin në mjaltë dhe kjo e bën të shantazhueshme në rast denoncimi. Nga burime të sigurta kam mësuar se ajo, për të mbuluar një aferë korruptive të një pushtetari vendor në Ksamil, ka përfituar një truall rreth 500 metra katrorë. - Heshti për një moment dhe vijoi të shpjegonte se trualli në fjalë nuk ishte regjistruar në pronësi të saj, por të djalit të mitur.

- Qenke i madh, - tha me eufori Mir Qorri. - Kjo po! Këtë fakt do t’ia nis të shkruar me një zarf. Mosdenoncimi është i barabartë me heshtjen, në të kundërt do t’i shkruaj Presidentit të Republikës për këtë aferë, do t’i them...

- Ka edhe më, - tha gjyqtari i Apelit të Tiranës dhe vijoi: - Një person i dënuar nga gjykata e Tiranës, si anëtar i një grupi kriminal, e kishte kontaktuar dhe i kishte kërkuar bashkëshortit të saj, që është kolegu im në Apelin e Tiranës, mbylljen e çështjes në këmbim të një apartamenti.

Miri fërkoj duart, duke e shfaqur hapur kënaqësinë që ndiente në atë çast. E shihte botën si një lëmsh që sillej rreth tij. “Gjithçka për mua”, thoshte në heshtje dhe nuk donte t’ia dinte për dhimbjen e tjetrit, mjaft që ai të mos e ndiente atë. Ishte në një gjendje deliri. Hyseni, si ta lexonte përbrenda, i tha të mos nxitohej se punët e mira bëhen pa zhurmë. Nga ana e tij, Endri e quajti si një surprizë të bukur zbulimin e aferave dhe

faktin që gjyqtarja tani e tutje do të ishte në dorën e tyre.

- Interesant sesi ndryshojnë gjërat, - tha pastaj.

- Gjërat ndryshojnë nëse përpiqemi t'i ndryshojmë. Çështja është se nuk duhet të rrëmbehemi nga ndjenjat e të ecim pa e matur hapin që hedhim, - tha gjyqtari. Pastaj u ngrit si me përtesë nga karrigia dhe u dha dorën miqve. - Më duhet të kthehem në Tiranë para orarit zyrtar, - tha dhe u largua. Ata porositën edhe nga një birrë dhe ndërruan temën e bisedës.

Biseduan fillimisht për gjëra të përgjithshme, pastaj Endri i foli për takimin me Lencin dhe sigurimin e sasive të konsiderueshme kanabisi për tregun përtej detit. Nuk përmendi emra, por vetëm skemën e organizimit dhe realizimit të trafikimit, nga Rrëzmali në brigjet e Vlorës, dhe transportin drejt vendit përtej detit. Tha se duheshin kontaktuar emrat që do ta prisnin, sipas grafikut, “mallin”, por dhe mënyrën e shmangies nga kontrollet e policisë këtu. Mir Qorri ishte përfshirë herët në kontrabandën e drogës dhe në punë të tjera të pista në Itali e më pas në Shqipëri, aktivitet ky me shumë fitime dhe që e kishte bërë “njeriun e fortë” të Vlorës. Në Itali ishte bërë pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të drogës dhe kishte kontakte ende me disa emra kontrabandistësh atje. Ishte kthyer dhe ndonëse në syrin e ciklonit për shkak të disa informatave që dispononte Njësia e Antinarkotikëve në Vlorë (bëhej fjalë për akuza të ngritura ndaj tij nga prokurorët dhe oficerët e ligjit në Europë, rezultat i përgjimeve telefonike etj.), asnjë rrebesh a furtunë

nuk e kishte trembur e zbrapsur. Jetonte në qetësinë e vet dhe nuk e vriste mendjen, pasi brenda policisë kishte njerëzit e tij, ndërsa njerëzit e pushtetit dhe të politikës drekonin e darkonin me të sa herë ai ua kishte nevojën. Endri ishte partneri i tij në biznes. Zotëronin pasuri të paluajtshme si toka të shumta në Bregdet, por edhe sipërfaqe ndërtimi të konsiderueshme. Blerja dhe shitja e pronave ishte biznesi i tyre më fitimprurës.

- Po me lekët e fituara nga shitja e skulpturave të Butrintit, ç'është bërë? - e pyeti befasisht Miri, pasi kishin biseduar gjatë për mënyrat dhe garancitë e trafikimit të kanabisit. Foli si ta kishin zgjuar nga një ëndërr e thellë dhe ta kujtonin për diçka me rëndësi.

- U takova me Beson në Butrint, por nuk biseduam për këtë temë, - tha Endri, ndërsa Miri Qorri, si tip inatçi që ishte, u ngrys në fytyrë si një natë e errët dhe ishte gati të shpërthente si tenxherja me presion. Endri nuk kishte një natyrë të nxituar dhe durimi nuk e tradhtonte në asnjë rast. I tha se duhej pritur, pasi ende nuk dihej nëse skulpturat e trafikuarra ishin në duar të sigurta. "Greku" i kishte thënë se personi që kishte marrë përsipër shitjen e tyre nuk gjendej.

- Mund të jetë fshehur. Si duket policia ka rënë në gjurmët e tij dhe ndoshta është në kërkim. Me sa duket çështja është më e ndërlikuar sesa mendonim, dhe do të ketë pasoja, - përfundoi Endri shpjegimin.

- Mirë, o mirë, po as më duhet t'ia di për pasojat. Na duhen paratë. Skulpturat i kanë grabitur në Butrint njerëzit tanë dhe ti e di këtë. Pazarin e kemi bërë që në fillim: sa do të fitonte ai, greku, dhe sa ne... - Endri

bëri një lëvizje mospërfillëse me dorë dhe kërkoi mirëkuptimin e bashkëbiseduesit për ta mbyllur këtë temë.

- Jam i shpërqendruar dhe tani truri më vërtitet si gjilpëra e magnetofonit, - tha. - T'i marrim gjërat me radhë, sepse me rrëmujë nuk zgjidhim asgjë. Tani për tani, problemi kryesor është përgatitja për procesin gjyqësor.

Miri nuk foli, por u ngrit i heshtur nga tavolina dhe ia bëri me shenjë Endrit për t'u larguar. Dolën, dhe teksa po u afroreshin autoveturave, e pyeti Endrin për gjyqtar Hysenin, nëse ishte i besueshëm apo... Endri buzëqeshi dhe, në vend të përgjigjes, i shtrëngoi fort dorën dhe i tha se do të shiheshin së shpejti. U ndanë...

**Planet** u ndërpre në ngjarjet që ndodhën më pas. Lidhjet me firmat piramidale në rrënim e bënë situatën të paparashikueshme. Mir Qorri arriti të shpërthente një pikë grumbullimi të parave, por vetëm kaq. Për të humbjet ishin domethënëse. Edhe për Endrin në Durrës, po ashtu, dhe kjo i kishte tronditur. Ditë më pas kishin folur gjatë në telefon. Miku i tij nga Vlora, Miri, ia përshkroi të gjithë ngjarjen, se si ishin mbledhur njerëzit te sheshi para Bashkisë dhe protestonin kundër qeverisë. Ishte mesjanari i vitit '97, një ditë e ftohtë dhe me erëra të fuqishme. "Po ndiej diçka që do t'i ngjajë furtunës", i kishte thënë Endrit në telefon. Edhe Endri e kishte një parandjenjë të tillë. Bashkë me shokët e tij mblidheshin dhe diskutonin për situatën. E ndienin